



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2021:195793  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05644309

**A.nr.2014/21**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative,** me gjyqtaren Valbona Gjonbalaj, me sekretaren juridike nazife Sheholli, në konfliktin administrativ, të paditësit XH.F. nga fshati ..., Komuna e ..., kundër të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-DMS në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktvendimit, në shqyrtimin kryesor publik të mbajtur në mungesë të palëve ndërgjyqëse, me datë 27.11.2017, merr këtë,

**A K T G J Y K I M**

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit, ... nga fshati ..., Komuna ..., me të cilën ka kërkuar, që të anulohet aktvendimi i të paditurës, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes në Prishtinë, me numër 37409, i datës 02.07.2021, si i kundërligjshëm.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike, është mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në mungesë të palëve ndërgjyqëse të thirrur në mënyrë të rregullt.

Paditësi në padinë ka theksuar se ka paraaahtruar kërkesë pranë organit të lartcekur që t'i vazhdohet e drejta në asistencen sociale, pasi që i është nderprerë dhe refuzuar kërkesa e tij, Paditësi ka parashtruar ankesë me nr. 1476 me dt.08.07.2021 pranë organit të lartcekur që t'i njihet kjo e drejtë e cila e refuzon duke lenë ne fuqi Aktvendimin me nr. 37409 të dt: 02.07.2021 të QPS-së më arsyetimin së familja gëzon dy pensione tetrapelgjike dhe paraplegjike vlera e të cilavë është 150 euro. Këshilli i ankesave pranë QPS-së dhe MPMS gjatë shqyrtimit të ankesës me nr. 1476, nuk ka shqyrtuar me arsyeshmëri te plotë shkresat në dosjen e ankuesit dhe pa ndonjë hulumtim, ekzaminim të thellë e ka refuzuar me arsyeshmërinë thuajse të njejtë duke lenë në fuqi vendimin e organit të shkallës së parë. Gjatë vlerësimit të komisionit i MPMS-së në mënyrë të gabuar vërtetohet gjendja faktike e paditësit, duke ju refuzuar e drejta në këtë Asistenc, edhe përkundër shëndetit fizik të dobët, iu kishte refuzuar kjo e drejtë, me arsyetimin fëmijet e tij janë përfitues të një pensionit të shtetit në shkall të dytë, e që realisht ata janë përfitues por ai pension nuk i mbulon as terapit e fëmijëve të tyre, pasi që terapit e tyre kontrollat janë shumë të kushtushme, ku ata janë të pa levizëshem dhe gjdo vizit të mjekët specialist duhet me taksit gjë që është shumë e kushtushme, andaj bazuar në dispozitat ligjore në fuqi saktësisht ne Ligjin nr.

2003/15 dhe Ligj. Nr. 04/L-96 per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr2003/15 per Skemen e Ndhimave Sociale ne Kosove dhe UA nr.06/2013 palës duhet ti nihet kjo e drejtë. Baza Ligjore, Ligjin nr. 2003/15 dhe Ligj. Nr. 04/L-96 per ndryshimin dhe plotesimin e Ligjit nr2003/15 per Skemen e Ndhimave Sociale ne Kosove dhe UA nr.06/2013. Duke marrë parasysh të lartcekurat, i propozoj Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - që pas administrimit të provave dhe pas përfundimit të seancës kryesore, të miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, ..., Anulohet Aktvendimi Nr. 37409 i dt. 02.08.2021, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë si të kundërligjshëm dhe Gjykata Meritorisht të miratojë kërkesën e paditësit për njohjen e të drejtës si përfitues të Ndhmës Sociale dhe kjo nga dita e paraqitjes së kërkesës.

E paditura, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Prishtinë, me përgjigjen në padi të datës 15.08.2023 e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit, duke i propozuar gjykatës që pas administrimit të provave, kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon në tërësi si të pa bazuar, ndërsa ta lenë në fuqi aktvendimin e të paditurës, si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Mbi këtë bazë, Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Ndhmës Sociale Shkalla e II-të/ Departamenti për Politika Sociale dhe Familjes -DPSF, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe ka konstatuar se Familja nuk i plotëson kriteret për ndihme sociale, sipas verifikimit nga komisioni i verifikues i QPS-së në Podujevë, është konstatuar se: Familja nuk i ka plotësuar kriteret për ndihmë sociale, dhe ankesa e paditësit i është refuzuar, duke lënë në fuqi Aktvendimin e dt.02.07.2021 nr.37409, lidhur me dispozitat ligjore të nenit 5 paragrafin 5.7, dhe 5.9 të Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, si dhe nenin 5.7a të Ligjit Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15, neni 8 paragrafi 1.2 dhe neni 10 paragrafi 1.8 te Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 06/2013 për Përlllogaritjen e të Mirave Materiale dhe jo Materiale si dhe të Hyrave të Llogaritshme dhe jo të Llogaritshme, SESPE familja nuk përzgjidhet, dhe nuk i njihet e drejta për vazhdimin e realizimit të ndihmës sociale. Për faktin se dy nga anëtarët e familjes gëzojnë të drejtën e pensionit Paraplegjik dhe Tetraplegjik, në shumë 150 euro. Provë: Aktvendimi me nr. 37409 i datës 02.08.2021 dhe Aktvendimit nr.37409 i datës 02.07.2021 i QPS në Podujevë. Andaj, e paditura deklaron se vendimi i atakuar me padi është akt administrativ i drejtë dhe i ligjshëm, i cili ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, konform dispozitave ligjore të cekuar si më lartë dhe është nxjerrë konform neni 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si në hyrje, dispozitiv dhe arsyetimin e tij, ashtu që paditësit i është refuzuar ankesa si e pa bazuar në ligji.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në seancën e shqyrtimit kryesor ka bërë administrimin e provave dhe atë: Vendim A.nr.136/21-01, i t. 02.09.2021, për aprovimin e ndihmës juridike falas, Aktvendim i dt. 02.08.2021, nga MFPT, Kopja e Librezës për Ndhimë Sociale, Nr.regj.47409, dt.05.01.2021, Sqarim për përgjigje në padi dt.17.07.2023, Aktvendim Nr. Lëndës 37409, i dt. 23.09.2020, nga MPMS, Dëftesë mbi Parashtrimin e kërkesës për ndihmë sociale, dt.02.09.2020, Formular për përlllogaritjen e të mirave materiale, Nr.serik 226654, dt.02.09.2020, Deklaratë për Bashkësinë Familjare Nr.ser. F 10162519, i dt.13.07.2016, Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile Nr.ser. E 20826630, i dt. 12.07.2016, Ekstrakt nga Regjistri Qendro i Gjendjes Civile, Nr.ser. E 20826637, i dt.12.07.2016 në emër tët ..., Certifikatë e Martesës Nr.ser. M 10116551, i dt. 23.02.2016, Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile Nr.ser. E 20868589, i dt. 26.07.2016, në emër të ..., Ekstrakt nga Regjistri Qendror i Gjendjes civile Nr.ser. 20868601, i dt. 26.07.2016, në emër të ..., Ekstrakt nga Regjistri Qendror i gjendjes Civile N.ser. E 20830849, e dt.13.07.2016, në emër të ..., Dëftesë për parashtrimin e kërkesës për ndihmë sociale, dt. 06.09.2019, Formular p137r p137rlllogaritjen e t137 mirave materiale dt.02.09.2019, Vlerësimi i Komisionit Mjekësor, 02.10.2016,

Rivler137simi i dt.03.10.2017, Vlerësim mjekësor i dt.01.09.2016, 01.10.2019, 03.11.2020, Raport nga Konsulta Mjekësore, dt. 14.08.2017,04.04.2019, 11.07.2016, 20.09.2020, 02.08.2020, Raport Specialistrik nga Qendra Diagnostike dhe Terapeutike “**Neuromedica**” dt. 11.07.2016, 14.08.2017,Udhëzim për konsultim dt.11.07.2016, 01.09.2020, 09.03.2016, 07.07.2016, 13.08.2020, 02.09.2020,01.09.2020, 20.08.2020, Raport nga Konsulta dt.02.09.2020, 04.09.2020, 27.08.2018,03.09.2019,29.08.2018, 27.08.2018, 02.09.2019, 07.07.2016, 02.08.2018, 02.08.2017, 01.09.2020, 09.03.2016, 03.08.2020, 13.08.2020,Vlerësim i Komisionit Mjekësor, dt. 02.10.2017, Ankesa e dt.08.07.2021, nga paditësi, Aktvendim dt.02.08.2021,Aktvendimi Nr.Lënde 37409, i dt.02.07.2021, nga MPMS, Komunikim elektronik i dt. 14.08.2023, 05.07.2023, Aktvendim 374/09 dt.23.09.2020, Parashtrimi i kërkesës për ndihmë sociale,

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të goditur në përputhje me nenin 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Me aktvendimin e Qëndres për Punë Sociale në Podujevë, të datës 02.07.2021, paditësit i është ndërprer pagesa për ndihmë sociale.

Kundër vendimit mbi ndërprerjen e pagesës së ndihmës sociale paditësi ka parashruar ankesë me datën 08.07.2021 tek e paditura.

Në procedurën sipas ankesës, Komisioni për Ankesa i MPMS-së, më dt.02.08.2021, ka marrë aktvendim me të cilin e ka refuzuar ankesën e paditësit dhe ka lënë në fuqi aktvendimin numër 37409 të datës 02.07.2021, të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Podujevë.

Për të vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar gjykata iu referua Ligjin nr.2003/15, për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, përkatësisht nenit 5, paragrafi 7 të të njejtit ligj ku përcaktohet se “Të hyrat e llogaritshme përfshijnë, por nuk përkufizohen vetëm në këto: të hyrat e fituara dhe të pafituara, të hyrat e pranuar në mall, qiraja, dërgesat e parave, beneficionet që u janë dhënë anëtarëve të familjes sipas Rregullores 2000/66, e cila administron “Beneficionet për invalidët e luftës dhe të afërmit e atyre të cilët kanë vdekur si pasojë e konfliktit të armatosur në Kosovë” , pensionet e sistemit të Pensioneve Individuale të Kursimit dhe Pensioneve Plotësuese Individuale ose të Punëdhënësve, siç është paraparë me Rregulloren 2001/35, pensionet që mirren nga jashtë, disa pagesa të përgjithshme, dhe lloje të ndryshme të të hyrave, siç do të saktësohen në Udhëzim. Të mirat materiale të pallogaritshme përfshijnë: Pensionin Themelor (siç përkufizohet në Rregulloren 2001/35 dhe në Ligjin mbi Metodologjinë e përcaktimit të Pensionit 5 themelor në Kosovë ), Pensionin e Aftësisë së Kufizuar (siç përkufizohet në nenin 2 pikën 3 të këtij Ligji ), disa pagesa të përgjithshme, pagesat e njëhershme që u jepen familjeve që fitojnë të drejtën në ndihmë sociale, siç përcaktohet në këtë Ligj, prodhimi shtëpiak për konsum familjar, disa lloje të caktuara të kredive dhe ndihmave financiare dhe lloje të tjera të të hyrave, siç saktësohen në Udhëzim”. Po ashtu, gjykata iu referua Ligjit nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë, përkatësisht nenit 5, paragrafi 5.3 të të njejtit ku parashihet që “Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 5.7. riformulohet me tekstin si në vijim: 5.7. Të hyrat e llogaritshme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto: të hyrat e fituara, të trashëguara, dhurata, të hyrat e pranuar në mall, qiraja, dërgesat e parave, beneficionet që u janë dhënë anëtarëve të familjes sipas Ligjit për vlerat e luftës, pensionet e kursimeve individuale dhe pensioneve plotësuese individuale ose të punëdhënësve, pensionet që merren nga jashtë, disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave.”Me UA 06/2013, me nenin 8 përcaktohet se “Të mirat materiale të llogaritshme janë sendet me vlerë që përfshijnë; 1.1. pagesat e përgjithshme nga pensionet individuale të

kursimit, që iu iepen personave ose përfituese siç përcaktohet në ligjet në fuqi; 1.2. pagesa të tjera të përgjithshme;. Ndërsa me nenin 10 po të këtij Udhëzimi Administrativ përcaktohet se “Të hyrat e llogaritshme par.1 . Te hyrat e llogaritshme përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto pika 1.8 “ disa pagesa të përgjithshme dhe lloje të ndryshme të të hyrave”.

Nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga aktvendimi i lëshuar nga nga e paditura e datës 02.08.2021, gjykata vëren se tani paditësi familja realizon dy pensione paraplegjik në shumë prej 150 Euro në muaj,dhe si e tillë tejkalon shumë e ndëihmës sociale, ndërsa të hyrat nga kjo konsiderohen të hyra financiare të llogaritshme konform dispozitave të lartëcituarra të Ligjit nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale si dhe Udhëzimit Administrativ nr.06/2013 neni 8 dhe 10, par.1, pika1.8. Andaj, në prezencën e këtyre rrethanave, familja e paditësit nuk i plotëson kushtet për të qenë përfituese e ndihmës sociale.

Gjykata vërenë se organi i shkallës së dytë ka vlerësuar drejtë gjendjen faktike, pasi ka bërë shqyrtimin e të gjitha fakteve relevante dhe dokumenteve ka konstatuar se familja e paditësit nuk i plotëson kriteret për ndihmë sociale dhe një vendim i ndryshëm do të ishte në kundërshtim me nenin 5.7 të Ligjit Nr.2003/15 Për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë si dhe nenit 5.3 të Ligjit nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë.

Në këtë kuptim, gjykata vlerëson se aktvendimi i të paditurës i dt.02.08.2021, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se me këtë aktvendim, paditësit nuk i është cenuar ndonjë e drejtë ligjore.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet e paditësit, të dhëna në padi, por nga provat e administruara, gjeti se ato nuk janë me ndikim, për vendosjen ndryshe të kësaj çështje administrative.

Nga kjo gjykata vëren se aktvendimi kontestues, është i drejtë dhe i bazuar në ligj dhe se organi i paditur, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar ligjin material. Mbi këto arsyeza kërkesëpadinë e paditësit nuk e aprovoi, sepse vlerëson se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit.

Duke u bazuar në të dhënat e lartëcekura, gjykata në kuptim të nenit 43, 46.2, lidhur me nenet 5, 6 dhe 38 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti për Çështje Administrative**  
**A.nr.2014/2021, datë 23.04.2024.**

Sekretarja jurisike  
Nazife Sheholli

G j y q t a r j a  
Valbona Gjonbalaj

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.